



SHKOLLA “LUIGJ GURAKUQI” TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Për: **Shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k**

Adresa: Tiranë, Dajt, Lagja Qesarakë, Godinë banimi dhe shërbimesh, Kati I

* * *

Procedura e prokurimit: ”Kërkesë për Propozim”/ Marrëveshje Kuadër me objekt: **“Blerje artikuj ushqimorë për Shkollën Luigj Gurakuqi për vitin 2019”**,

Numri i referencës së procedurës/lotit të katërt: **Ref-95637-11-23-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është **”Blerje artikuj ushqimorë për Shkollën Luigj Gurakuqi për vitin 2019”, Tirane.**

Fondi limit: ”Blerje artikuj ushqimorë për Shkollën Luigj Gurakuqi për vitin 2019” është **3.237.500 (tremilion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit dhe buxheti i Bashkisë Tiranë.

Publikime të mëparshme : Buletini i Njoftimeve Publike Nr.48, date 03 Dhjetor 2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik “ **Erdi** ” sh.p.k
K71804011J

NUIS

Vlera e ofertës = **2.824.065 (dymilion e tetëqind e njëzet e katërmijë e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.**

2- Operatori ekonomik “ **Dajti Park 2007**” sh.p.k

NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **2.920.510 (dymilion e nëntëqind e njëzet mijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.**

3- Operatori ekonomik “**Nelsa**” shpk

NUIS J71601012S

Vlera e ofertës = **2.942.235 (dymilion e nëntëqind e dyzet e dymijë e dyqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh.**

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

**1- Operatori ekonomik “Erdis” sh.p.k
K71804011J**

NUIS

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1- Operatori ekonomik “Erdis” shpk

NUIS K71804011J

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga kjo shoqëri, nga ku rezultoi si më poshtë:

1. Në kriteret e vecanta për kualifikim pika 1, gërma b është kërkuar sa më poshtë:

Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

- Operatori ekonomik “Erdis” shpk në dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim sipas shtojcës 4 për përmbushjen e specifikimeve teknike, ka plotësuar deklaratën me emrin e operatorit ekonomik Nelsa shpk dhe ka konfirmuar administratori i shoqërisë Erdis shpk Elvis Balla. Pra ka mosperputhje midis emrit të operatorit ekonomik me të cilin është plotësuar deklarata dhe atij që ka konfirmuar deklaratën duke mos plotësuar pikën 1 gërma (b) të Kriterëve të Vecanta për kualifikim.
- 2. Në kriteret e vecanta për kualifikim pika 1, gërma c është kërkuar sa më poshtë

Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

- Operatori ekonomik “Erdis” shpk në dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim sipas shtojcës 6 për konfliktin e interesit, ka plotësuar deklaratën me emrin e operatorit ekonomik Nelsa shpk dhe ka konfirmuar administratori i shoqërisë “Erdis” shpk Elvis Balla. Pra ka mosperputhje midis emrit të operatorit ekonomik me të cilin është plotësuar deklarata dhe atij që ka konfirmuar deklaratën duke mos plotësuar pikën 1 gërma (b) të Kriterëve të Vecanta për kualifikim.
- 3. Në kriteret e vecanta për kualifikim pika 1.3 kapaciteti ekonomik për automjetet është kërkuar sa më poshtë
- Automjet të pershtatshëm (frigoriferik ATV) për artikujt bulmet dhe mish (1 cope).
Për automjetet të paraqiten **certifikatat e pronesise, kontratat e dhurimit apo të qirase sipas rastit**, si dhe dokumentacionin përkatës Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion të automjeteve në dispozicion si dhe leje për transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare të mjetit. (dokumentacioni i kërkuar të jete i vlefshëm në përputhje me

dispozitat ligjore në fuqi) .

- Operatori ekonomik duhet të **disponoje automjet** te pershtatshem per transportin e bukes
- Per automjetin te paraqitet certifikatat e pronesise , kontratat e dhurimit apo te qirase sipas rastit si dhe dokumentacionin perkates Certificate e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe siguracionin e mjetit ne dispozicion si dhe leje per transport mallrash si dhe leja higjeno-sanitare te mjetit (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshëm ne perputhje me dispozitat ligjore në fuqi) .

Ne plotësim të kësaj pike operatori ekonomik ka paraqitur mjetet si më poshtë:

- Mjeti me targa AA 942CM me kontrate qeraje Nr.5355 Rep, Nr.4188 kol, date 14.06.2017 te lidhur me shoqërinë "SOAL" shpk i cili ka dokumentacion te rregullt shoqërues
- Mjetin me targa AA 975FK me kontrate qeraje Nr.1185 Rep, Nr.885kol, date 08.02.2018 te lidhur me shoqërinë "Ferra & Co" shpk per të cilin nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së mjetit si dhe leja për transport mallrash nuk është e vlefshme pasi skadon me datë 25.02.2018.
- Mjetin me targa AA 097 EZ me kontrate qeraje Nr.4035 Rep, Nr.8957 kol, date 09.12.2016 te lidhur me shoqërinë "Extramilk" shpk per të cilin nuk është paraqitur certifikata e pronësisë së mjetit.

Sa më sipër nga mjetet e paraqitura vetëm njëri është paraqitur me dokumentacion te rregullt shoqërues duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, pika 1.3 Kapaciteti Teknik ku kërkohen 2 mjete njëri te jetë frigoriferik per produktet e mishit dhe bulmetit dhe tjetri i pershtatshem per transportin e bukes.

Sqarojmë se në pikën 1 te Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar) Neni 46 "Kualifikimi i ofertuesve", citohet sa me poshte:

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...

Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe në mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se është identifikuar si operator ekonomik i suksesshëm:

4- Operatori ekonomik “ **Dajti Park 2007**” sh.p.k

NUIS K11507003S

Vlera e ofertës = **2.920.510 (dymilion e nëntëqind e njëzetmijë e pesëqind e dhjetë) lekë pa TVSH**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Shkollës Luigj Gurakuqi, Tirane me adresë Rruga: “Aleksandër Moisiu”, pranë IKV, tel: 355 42 23 75 071, brenda 3 (tre) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **11.12.2018**

Ankesa: Gjatë afatit Ligjor për pritjen e ankesave të shoqërive pjesmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për **”Blerje artikuj ushqimorë për Shkollën Luigj Gurakuqi për vitin 2019”, Tirane** nuk është paraqitur asnje ankesë.

Me respekt,

